KOMISIONI RREGULLATOR
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 5 paragrafi (1) të Rregullores së Formulimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse për Transport ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/20 dhe 133/20), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriutnë seancën e mbajtur më 22 tetor 2020, mori

# Vendim

për përcaktimin e dendësisë së eskaluar $\rho_e$ dhe dendësisë së deeskaluar $\rho_d$ të secilit derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport, shumës P të kompensimit për premi, shpenzimet T të transportit deri në depozitë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe shumën D të kompensimit për shpenzimet e punës nëpërmjet depozitës dhe marzhës tregtare me shpenzimet e përfshira të transportit nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundit

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet dendësia e eskaluar $\rho_e$ dhe dendësia e deeskaluar $\rho_d$ e secilit derivat të naftës dhe e lëndës djegëse për transport, shumës së P të kompensimit për premi, shpenzimet T të transportit deri në depozitë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe shumën D të kompensimit për shpenzimet e punës nëpërmjet depozitës dhe marzhës tregtare me shpenzimet e përfshira të transportit nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundit, të cilat do të zbatohen në periudhën nga 27.10.2020 deri më 25.04.2021.

Neni 2

(1) Dendësia e deeskaluar $\rho_d$ e secilit derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport sipas nenit 2, paragrafi (1) të Rregullores së Formulimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse për Transport, me përjashtim të mazutit M-1, është:

- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 ................ 0,747 (kg/l),
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 98................ 0,751 (kg/l),
- për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) ........ 0,824 (denarë/ litër ) dhe
- për vaj për djegie - Ekstra i Lehtë 1 (EL-1) ................ 0,824 (kg/l).

(2) Dendësia e eskaluar $\rho_e$ e secilit derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport sipas nenit 2, paragrafi (1) të Rregullores së Formulimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse për Transport, me përjashtim të mazutit M -1, është:

- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 ................0,755 (kg/l),
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 ................0,755 (kg/l),
- për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) ........ 0,845 (kg/l) dhe
- për vaj për djegie - Ekstra të Lehtë 1 (EL-1) ...............0,845 (kg/l).

rr. Makedonija nr. 25, pallata Llazar Pop-Trajkov, kati i 6 • 1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut
Qendra 02 3233-580 • Faksi: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

Neni 3

Kompensimi për preminë (P) për secilin derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport është:

- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 ................72 USD/t ,
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 ................114 USD/t,
- për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) .........53 USD/t,
- për vaj për djegie - Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)................ 55 USD/t dhe
- për mazut M-1............................................................65 USD/t.

Neni 4

Kompensimi më i lartë T për shpenzimet e transportit deri te depozita në Republikën e Maqedonisë së Veriut për secilin derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport është:

- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 ......... ....20 USD/t ,
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 ............ .20 USD/t,
- për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)...... 20 USD/t,
- për vaj për djegie - Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)............... 20 USD/t dhe
- për mazut M-1.......................................................... 20 USD/t.

Neni 5

(1) Kompensimi më i lartë D për secilin derivat të naftës, përveç për mazut M-1, në shumë të përgjithshme prej 6,25 MKD/l, përllogaritet si shuma e kompensimeve më të larta për shpenzimet e punës nëpërmjet depozitës, marzhës tregtare dhe shpenzimeve për transport nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe konsumatorët e fundit, të cilët për secilin derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport veçmas janë:

a) Shpenzimet për punën përmes depozitës:

(1) për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 ............1,00 MKD/l,
(2) për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 ............1,00 MKD/l,
(3) për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) ... 1,00 MKD/l dhe
(4) për vaj për djegie - Ekstra të Lehtë 1 (EL-1)...........1,00 MKD/l.

b) Marzha tregtare:

(1) për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 ............ 4,5 MKD/l,
(2) për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 .............4,5 MKD/l,
(3) për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) .... 4,5 MKD/l dhe
(4) për vaj për djegie - Ekstra të lehtë 1 (EL-1).............4,5 MKD/l.

c) Shpnezimet e transportit nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundit:

(1) për benzinë motori EUROSUPER BS – 95............ 0,75 MKD/l,

(2) për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 ............0,75 MKD/l,

(3) për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)..... 0,75 MKD/l dhe

(4) për vaj për djegie - Ekstra të Lehtë 1 (EL-1)...........0,75 MKD/l.

(2) Kompensimi D për mazut M-1 është 2,5 MKD/kg dhe ai nuk e përmban kompensimin e marzhës tregtare me shpenzimet e përfshira për transport nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet nga data 27.10.2021.

**PA1, nr. 02-2148/1**
**22 tetor 2020**
**Shkup**

**Kryetar i**
**Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

**Марко Бислимоски**